

4. ANALIZA E RREZIKUT DHE RRËSHQITJET NË ZONË

4.1 Historiku i shkurtër i ndërtimeve në kodrën e Cfakës:

Si thamë dhe më lart gjithë kodra është e mbuluar nga ndërtimet, kryesisht një deri tre kate që vendosen mbi depozitimet flishore ose dhe mbi depozitimet kuaternare.

Ndërtimi i dy pallateve gjashtëkatshe për të cilat është kërkuar studim, kanë filluar para vitit 1990 dhe kanë përfunduar pas vitit 1993.

Pas ndërtimit të pallateve në zonën ekodrës së Cfakës, që kufizohet me rugën nacionale Gjirokastrë – Kakavie, filloi gërmimi i shesheve dhe ndërtimi i objekteve të ndryshëm.

Kështu u ndërtuan objektet: A, B, C dhe më në jug dhe objekte të tjera. Pas këtyre ndërtimeve në vitet e fundit po ndërtohet një godinë shumëkatshe në zonën e Postbllokut. Gjithashtu midis dy pallateve gjashtëkatshe si në jug dhe veri të tyre janë ndërtuar objekte të ndryshme.

4.2 Analiza e fenomeneve gjeodinamike që ndikojnë në rrëshqitjen e formacioneve:

Nga ana jonë u kryen vërtetime në objektet që specialitet e bashkisë kishin shqetësime, sepse këto objekte rrezikoheshin nga rrëshqitja.

- a. Në objektin shtëpi banimi e Riza Kasit që vendoset në perëndim të urës së Nanxës, shtëpia kishte disa të çara të vogla në dyshe dhe mure në pjesën e përparme të shtëpisë.

Kjo shtëpi është ndërtuar sipas rënies së formacioneve flishore, kështu që mundësia e rrëshqitjes në drejtim të veriut është e vogël. Nga vërtetimet tona çarjet janë krijuar nga çedimi i themeleve në pjesën e përparme. Nuk takuam bazë rrëshqitje në aksin e përroit të Nanxës.

Shkaqet e çedimit të themeleve janë rrjedhja e ujrave sipërfaqësore nëpër shpat pa asnjë kanalizim. Gjithashtu ujrë e çatisë së shtëpisë binin mbi themele, duke i tjetërsuar formacionet.


- b. Në objektet e shpatit lindor të kodrës së Cfakës

Objektet e kësaj zone dhe gjithë kodra e vërtetuar, duke filluar nga Postblloku deri në murin jugor rrethues të objektit janë në rrezik rrëshqitje për disa fenomene që po i analizojmë më poshtë:

- Shtëpitë e banimit e Mina Rrapos dhe Alfred Rrapos rrezikohen të rrëshqasin për shkak të gërmimeve të sheshit të pallatit shumëkatësh që është duke u ndërtuar. Nga vërtetimet tona skarpiti i krijuar u është afëruar këtyre shtëpive në veri dhe në lindje në 3 - 4 metra dhe çarjet e formacionit flishor janë afëruar edhe më shumë deri afër themeleve. Shkak tjetër që favorizon rrëshqitjen janë edhe ujrat e shiut që grumbullohen mbi çati dhe nëpërmjet tubove derdhen direkt në themelet e shtëpive. NR. 1 dhe Nr 2.



Skarpate vertikale dhe carje te krijuara nga germimet e sheshit te pallatit shumekatesh ne zonën e postobllokut



Carje në shtëpinë e Riza Kasi



Rreshqitje dhe carje ne zonen e postobllokut nga pallati qe eshte në ndërtim

- Pallatet gjashtëkatshe të ndërtuara në majën e dy kodrinave (Shiko hartën dhe profilin (A - A) janë të rrezikuara të rrëshqasin ose të shkatërrohen. Rrëshqitja e shpateve në këtë zonë do të shkatërronte plotësisht jo vetëm këto pallate, por edhe objektet A, B, C të vendosura në buzë të rrugës automobilistike.

Nga vërtetimet tona në këto objekte kemi konstatuar mikroçarje të vogla në katin e katërt e të pestë në muret e pallateve.

Për aktivizimin e fenomenit të rrëshqitjes së këtij shpati në kodrën e Cfaqës veprojnë disa faktorë:

- Faktori kryesor është që formacionet flishore janë prerë në bazën e tyre duke krijuar faqe të lirë e duke qenë se rënia e relievit dhe ajo e shtresave është në një drejtim, në një moment të caktuar nga dobësimi i kontaktit midis shtresave flishore për shkak të ujrave ose nga tërmeti i vogël, shpati do të fillojë të lëvizë, duke shëmbur ndërtesat (Shiko profilin A - A). Rezikun e rrëshqitjes e shton dhe fakti që shpatet me lartësi 2,5 - 4 metra që janë krijuar nga gërmimet për krijimin e shesheve të objekteve A, B dhe C nuk janë mbrojtur me mure mbrojtëse dhe vepra të tjera inxhinierike (Shiko profilin A - A)
- Faktor tjetër i rëndësishëm që stimulon rrëshqitjen e shpatit janë ujrat sipërfaqësore. Këto ujra rrjedhin pa asnjë lloj kanalizimi nëpër sheshet e pallateve dhe gjatë shpatit, gjë që sjell ndryshimin e vetive gjeologjike - inxhinierike të formacioneve.
- Faktor i rëndësishëm për stimulimin e rrëshqitjes janë ujrat që zbresin nga tarraca e dy pallateve nëpërmjet tubave si dhe ujrat e bardha dhe të zeza. Këto ujra që fitojnë dhe presion nga mbledhja e tyre në tubo vertikale shkarkohen me presion mbi kokat e shtresave flishore, ku janë themelet e pallateve. Kemi vërejtur që në pallatin Nr. 2 lartësia e tubave të shkarkimit nga sipërfaqia është dy deri tre metra dhe nga presioni që bien ujrat e tarracës është shkatërruar bordura mbrojtëse e themeleve. Ujrat e bardha dhe të zeza dedhen nëpër shpat, duke infiltruar në shtresat ranoro - alevrolito - sargjilore të flishit dhe duke u prishur struktura e tyre fillestare.

Midis pallatit Nr 1 dhe Nr 2 kemi konstatuar se është krijuar një tarracë e vogël 200 - 300 m² që mbillet me zarzavate. Duke u ujitur herë pas here prishin strukturën e formacioneve të shpatit dhe për këtë duhet të prishen. Per pallatin Nr. 1 ndikim kanë dhe gërmimet e bëra në pallatin e ri shumëkatës që ndërtohet. Po të vërojmë profilin tërthor të kodrës së Cfaqës (Shiko profilin A - A) shikohet që nga gërmimet në objektin A janë prerë kokat e shtresave; të cilat sipas rënies 22° bien në mesin e sheshit të pallatit Nr. 1 Rrëshqitja e tyre sjell domosdoshmërisht shkatërrimin e pallatit. Po kjo është dhe në pallatin Nr. 2

SPECIALE (S.O.S)

Kodra e studiuar e Cfakës është ME gjendje të kërcënuar qëndrueshmërie, se shtresat e formacionit bazë janë flishe të Oligocenit të poshtëm, kanë një rënie 20 - 25° në drejtim të rënies së relievit (Shiko profilin A – A). Këto formacione janë ndërthurje shtresash ranorësh, alevrolitesh dhe argjilash. Janë formacione me çimetim të dobët deri mesatar dhe janë shumë të paqëndrueshme karshi veprimt të ujrave.

Nga ndërhyrjet e shpeshta për ndërtim në kodër qysh herët janë krijuar premisa për krijimin e çarjeve, zbulim dhe prerje të kokave të shtresave, të cilat lejojnë në kohën e shirave infiltrimin e ujrave në brendësi të shkëmbit.

Në shtresat e alevroliteve (Me koeficient filtrimi të vogël) uji rrjedh gjatë shtresës argjilo-alevritore, të cilat bien në drejtim të shpatit. Nga prania e ujrave në këto shtresa, koeficientët e qëndrueshmërisë, këndi i fërkimit të brendshëm ϕ dhe kohezioni C zvogëlohen shumë dhe masa e shkëmbit humbet qëndrueshmërinë dhe rrëshqasin në drejtim të rënies së shtresave, por edhe të skarpatës njëkohësisht. Kjo kodër në gjëndjen e sotme është në një gjysmë ekuilibri, por gjithmonë është e kërcënuar për t'u shkatërruar pa paralajmërim, mbasi rrëshqitjet në formacionet flishore janë të shpeshta dhe shpesh pa paralajmërim.

Një rast i tillë ka ndodhur në qytetin e Gjirokastrës. Nga rrëshqitja e shpatin u shkatërrua një pallat, ku pati dhe viktima.

Ju lutemi, shikojeni me vëmendje gjëndjen, qoftë edhe këtë aktuale, se po nuk u morën masa mbrojtëse, ky shpat i kodrës së Cfakës është shumë i rrezikuar.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Në kodrën e Cfakës takohen depozitimet flishore të Kuaternarit dhe ndërtohen nga ndërthurja ritmike e shtresave ranore, alevrolitore dhe argjilore.
2. Rekomandojmë që në objektin shtëpi banimi të z. Riza Kasi të bëhet shkarkimi i ujrave të tarracës në përrua dhe jo mbi themelet e banesës. Çarjet e konstatuara janë si rezultat i infiltrimit të ujrave në themelet e banesës.
3. Të monitorohet nga bashkia rreziku i rrëshqitjes së shtëpive të z. Mina Rapo e Alfred Rapo në zonën e Postbllokut. Këto banesa rrezikohen të shëmben për shkak të gjurmimeve për krijimin e sheshit të ndërtimit të pallatit shumëkatsh, që është në ndërtim.
4. Domosdoshmërisht duhet të merren masa mbrojtëse për skarpatat e formuara nga gjurmimet për krijimin e sheshit të ndërtimit të pallatit shumëkatsh në zonën e Postbllokut. Këto gjurmime rrezikojnë jo vetëm banesat njëkatshe që përmendëm më lart, por dhe pallatin gjashtëkatsh Nrt. 1.
5. Të ndalohen ndërtime të çdo lloji në zonën postblloke deri në objektin C përgjat kodrës së Cfakës.
6. Të ndërtohen vepra mbajtëse inxhinierike në shpatet e krijuara nga ndërtimi i objekteve A, B, dhe C.
7. Të projektohet një vepër mbajtëse inxhinierike në lindje të pallatit Nr. 1 dhe Nr. 2 ku janë ndërtuar këto pallate.
8. Të evitohet domosdoshmërisht rrjedhja e ujrave sipërfaqësore dhe sidomos ujrë që shkarkohen nga tarracat e pallateve Nr. 1 dhe Nr. 2 në bazamentin e pallateve

si dhe ujrë e bardha e të zeza, duke i kamnalizuar në përroin që ndodhet midis dy pallateve.

9. Të vlerësohen nga bashkia seriozisht rekomandimet e dhëna, se në objektet e kodrës së Cfaqës, pjesa lindore, rreziku i rrëshqitjes së skarpatit dhe shkatërrimit të objekteve që janë ndërtuar në këtë zonë është emergjent.

Ing. Gjeolog

Çano Nora



Ing. Gjeolog

Thanas Llahana

